



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:063811

Datë: 21.03.2025

Numri i dokumentit: 07025998

C.nr.837/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K .nga M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E.I., avokat nga M., kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.M., avokat nga P., me objekt kontesti kompensimin e shujtës ushqimore, jashtë seancës, me datë 21.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.K. nga M., dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore, në Mitrovicë, që paditëses, në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, respektivisht për periudhën 12 mujore, t'ia kompensoj shumën prej 50.00€ (pesëdhjetë euro) në muaj apo shumën e përgjithshme prej 600.00€ (gjashtëqind euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë, më datë 12.02.2024 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore, në Mitrovicë, që paditëses, në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri me 31.12.2020, respektivisht për periudhën 24 mujore, t'ia kompensoj shumën prej 50.00€ (pesëdhjetë euro) në muaj apo shumën e përgjithshme

prej 1,200.00€ (njëmijë e dyqind euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë, më datë 12.02.2024 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm, si e pabazuar.

III. OBLIGOHET e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore, në Mitrovicë që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguaj shumën prej 124.00€ (njëqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZHET kërkesa e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën e kërkuar prej 260.00€ (dyqind e gjashtëdhjetë euro), përtej shumës së gjykuar në shumë prej 124.00€ (njëqind e njëzet e katër euro), si në pikën III të dispozitivit, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësja B.K. nga M., përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datë 12.02.2024, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ushqimore, të cilën e ka plotësuar dhe precizuar me parashtrësën e datës 19.11.2024. Në padi paditësja ka theksuar se e njëjta është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe se duke u bazuar në pikën 2 të Vendimit me nr.02/06-4136/10, të datës 02.08.2010, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut, i cili vendim është ende në fuqi e me të cilin është paraparë që shërbyesve civil në administratën komunale, në emër të shujtës ushqimore i'u lejohen nga 50.00€ në muaj, duke filluar nga muaji Prill i vitit 2010, dhe në dispozitën e nenit 55 par.2 të Ligjit të Punës, pasi që e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj kundrejt paditëses pavarësisht kërkesës së kësaj të fundit, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyroj të paditurën që paditëses në emër të shujtës ushqimore për vitet 2019, 2020 dhe 2022, t'ia kompensoj shumën prej 50.00€ në muaj, që për një vit i bie shuma prej 600.00€, respektivisht për tre vite ka kërkuar kompensimin e shumës prej 1,800.00€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë: shumën prej 21.00€ në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë, shumën prej

104.00€, në emër të përpilimit të padisë, dhe shumën prej 135.00€ për çdo seancë, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

E paditura Komuna e Mitrovicës së Jugut/Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, fillimisht me arsyetimin se kjo gjykatë nuk është kompetente për të shqyrtuar padinë e paditëses, pretendim ky të cilin e paditura e ka mbështetur në praktikë gjyqësore, duke i'a bashkangjitur përgjigjes në padi Aktvendimet e nxjerra nga Gjykata Themelore në Mitrovicë/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil C.nr.588/2021 të datës 16.02.2023, dhe atë C.nr.589/2021 të datës 16.02.2023, si dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.10879/21 të datës 13.01.2023. Tutje e paditura argumenton bazën juridike për refuzimin e kërkesëpadiës së paditëses, duke theksuar se kompensimi i shujtave nuk është paraparë as me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nënpunësve Civil e as me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, pastaj se ndarja e mjeteve buxhetore për paga dhe mëditje të tjera pa miratimin e Ministrisë së Financave është e kundërligjshme sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, respektivisht dispozitën e nenit 30 të këtij ligji. Pastaj sipas pretendimeve të të paditurës, Vendimi i Kuvendit të të paditurës, përmes të cilit ka shprehur vullnetin që t'i paguajë shujtat, nuk ka qenë në përputhje me dispozitat e lartpërmendura dhe nuk ka kaluar as testin e ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe në Ministrinë e Financave, si institucione përgjegjëse për mbikëqyrjen e akteve komunale sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale, ku si provë për të argumentuar këto pretendime ka bashkangjitur vendimin e Ministrisë së Financave me nr.të protokollit 2851-1/2022. Tutje ka shtuar se kërkesa e paditëses për periudhën kohore nga muaji Prill 2010 deri më datë 07.02.2021, është parashkruar sipas dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës. Në fund ka theksuar se kuvendi i të paditurës gjatë vitit 2021 dhe 2022, ka nxjerrë vendime të tjera për kompensimin e shujtave, të cilat e kanë zëvendësuar Vendimin Nr.02/06-4136/10 të datës 02.08.2010, mirëpo as këto vendime nuk e kanë kaluar testin e ligjshmërisë. Mbi bazën e të lartëcekurave i ka propozuar gjykatës dy kërkesa alternative dhe atë që të marrë aktvendim me të cilën kjo gjykatë shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore për shqyrtimin e padisë së paditëses, ose të marrë aktgjykim me të cilin e refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Pas vlerësimit të pretendimeve të palëve dhe provave të bashkangjitura nga ana e tyre, gjykata konstatoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk

ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës së nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe dispozitës së nenit 399 të LPK-së, e cila në par.1 përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, ndërsa në par.2 të saj përcakton se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”*

Gjykata gjen se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ishte në marrëdhënie pune te e paditura, pastaj nuk ishte kontestuese fakti i vijueshmërisë në punë të paditëses në vitin 2022. Poashtu nuk ishte kontestuese se paditura me Vendimin nr.02/06-4136/10, të datës 02.08.2010, kishte është paraparë që shërbyesve civil në administratën komunale, në emër të shujtës ushqimore i’u lejohen nga 50.00€ në muaj, duke filluar nga muaji Prill 2010 dhe se e paditura nuk e kishte përmbushur këtë detyrim ndaj paditëses, por kontestuese rezultoi të jetë ligjshmëria e vendimit të lartëcekur, parashkrimi i kërkesës dhe kompetenca e kësaj gjykate.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të bashkangjitura, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si të tillë të njëjtën edhe e aprovoi pjesërisht si të bazuar.

Gjykata gjen se me Vendimin nr.02/06-4136/10, të datës 02.08.2010, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut, respektivisht në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet se: *“Me këtë vendim MIRATOHET kërkesa e nëndegës së Sindikatës së Pavarur të Administratës komunale për implementimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Kosovës (MAP dhe MEF) dhe përfaqësuesve të Sindikatës së Pavarur të Administratës Publike të Kosovës.”*, ndërsa në pikën 2 të po këtij vendimi përcaktohet se: *“Konform pikës 1 të këtij vendimi, shërbyesve civil të Administratës Komunale në emër të shujtës i’u lejohen nga 50*

(pesëdhjetë)€ në muaj, duke filluar nga muaji prill i vitit 2010". Sipas pikës 4 të tij, ky vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa zbatohet prej datës 01.04.2010.

Nga akt emërimi i datës 14.03.2016, rezulton se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, në kohë të pacaktuar, nga data 20.12.2012, në pozitën udhëheqëse e njësisë së komunikimit publik.

Nga kërkesa me nr.protokolli 01/120/11-0015318/21 e datës 03.03.2021, rezulton se paditësja i është drejtuar me kërkesë të paditurës për kompensimin e shujtës ushqimore mujore.

Provave të lartcekura gjykata i'u fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësja është e legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqësve, në kuptim të dispozitës nga neni 245 i Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se: *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave në shkresat e lëndës, vërtetoi se paditësja në vitin 2022 ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën pasi që kontrata e saj e punës është lidhur në kohë të pacaktuar dhe poashtu as nga e paditura nuk u pretendua dhe as nuk provua e kundërta e kësaj, dhe se për këtë periudhë kohore për të paditurën në bazë të Vendimit nr.02/06-4136/10, të datës 02.08.2010, ka rrjedh obligimi që paditëses për çdo muaj, në emër të shujtës ushqimore t'ia kompensoj shumën prej 50.00€, por që deri më sot e paditura nuk e ka përmbushur një detyrim të tillë.

Së këndejmi gjykata gjen se baza juridike në të cilën gjen mbështetje kërkesa e paditëses si punëmarrës te e paditura është Vendimi nr.02/06-4136/10, i datës 02.08.2010, i nxjerrë nga kjo e fundit.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata mori parasysh faktin se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura përgjatë gjithë vitit 2022, andaj edhe në bazë të vendimit të lartëcekur të nxjerrë nga e paditura asaj i takon kompensimi i shujtës ushqimore, për periudhën 12 mujore, në lartësi prej 50.00€ në muaj, respektivisht në shumë të përgjithshme prej 600.00€, dhe si rrjedhojë gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses për këtë pjesë, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata mori parasysh pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, dhe gjeti se një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës të Kosovës, me të cilën parashihet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*, gjen se kërkesa e paditëses për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2020, respektivisht për shumën prej 1.200.00€ është parashkruar, pasi që kanë kaluar më tepër se 3 vite nga dita kur ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar mbrojtje gjyqësore e deri në paraqitjen e kërkesës në gjykatë, andaj edhe për këtë periudhë kohore, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke vendosur si në pikën II të dispozitivit,

Gjykata mori parasysh kundërshtimin e të paditurës lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës dhe gjeti se një pretendim i tillë nuk qëndron pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë për kompensimin e shujtës ushqimore, si derivat i vendimit të të paditurës nr.02/06-4136/10, të datës 02.08.2010, dhe meqenëse kjo e fundit nuk e ka përmbushur obligimin e saj që rrjedh nga ky vendim, atëherë kemi të bëjmë me kompensim të kërkesave materiale që rrjedhin nga marrëdhënia e punës me karakter detyrimor, dhe rrjedhimisht kjo gjykatë është kompetente për të gjykuar lidhur me këtë kërkesë.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimin e të paditurës lidhur me ligjshmërinë e vendimit nr.02/06-4136/10, të datës 02.08.2010, dhe gjeti se një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi që nga përgjigja e dorëzuar nga vet e paditura, përmes email-it të datës 15.11.2024 nga Udhëheqësi i Sekretarisë së Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës Jugore, e të pranuar si parashtresë nga i autorizuari i paditësit më datë 21.11.2024, është konstatuar fakti se vendimi i datës 02.08.2010, nuk është shfuqizuar asnjëherë me ndonjë vendim apo akt tjetër nga Kuvendi i Komunës, ndërsa në anën tjetër e paditura nuk ka ofruar asnjë provë se vendimi në fjalë është kontestuar nga autoriteti mbikëqyrës, respektivisht nëse është zhvilluar procedura e paraparë me dispozitën e nenit 81 dhe 82 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket kërkesës së Ministrisë së Financave nr.2851-1/2022, të cilës i referohet e paditura lidhur me rishqyrtimin e aktit, gjykata gjen se kjo kërkesë i referohet një vendimi tjetër të nxjerr nga e paditura më datë 31.10.2022, dhe jo vendimit në të cilin paditësi e mbështet kërkesëpadinë.

Lidhur me lartësinë e kamatës, gjykata vendosi në bazë të dispozitës së nenit 382 të LMD-së, e cila përcakton se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë më datë 12.02.2024.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në dispozitën e nenit 452 të LPK-së, për arsye se pala e paditur duke qenë se e ka humbur kontestin ka për obligim që palës paditëse t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€ (e paraparë sipas Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, Nr.Tarifor 6 dhe 17), dhe taksës gjyqësore për padi në shumë prej 20.00€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Gjykata refuzoi kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën e kërkuar prej 260.00€, përtej shumës së gjykuar prej 124.00€, si në pikën IV të dispozitivit, pasi që gjeti se lidhur me këtë çështje gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, që nënkupton se shpenzimet për përfaqësim në seancë gjyqësore në lartësi prej 135.00€ nuk janë shkaktuar dhe në emër të taksës gjyqësore paditësja ka paguar shumën prej 20:00€ dhe jo shumën prej 21:00€ siç e njëjta pretendon, respektivisht për provizion bankar sipas tarifës së lartëcekur nuk parashihet kompensimi.

Nga sa u tha më lart, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.837/2024, më datë 21.03.2025

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e nëpërmjet kësaj gjykate.